

URDHËR
Nr. 462, datë 16.3.2015

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR DHËNIEN E NDIHMAVE FINANCIARE
PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme, sipas nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie natyrore, tek zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 360, datë 28.3.2014 i ministrit të Mbrojtjes “Për delegim kompetencash për dhënien e ndihmave financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura”, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli